



Pranuar / Dorezuar Priliceno / Protifato Received / Delivered	17. 08. 2023	3 viti god year	
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHTCK	5710/2023		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.934/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.934/2023 të datës 07.07.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] kundër Vendimit me Nr. 7/2023 të datës 08.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "Masë disiplinore-largim nga shërbimi civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 17.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.934/2022 e datës 07.07.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. 7/2023 i datës 08.06.2023 i Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar sipas Akt Emërimit AE.Nr.393/2022 të datës 31.12.2022 në pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" në Departamentin Tatimor Rajonale në Mitrovicë në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës, më datë 20.12.2022 ka parashtruar kërkesë për pushim pa pagesë për trajtim shëndetësor nga data 01.01.2023 deri më datë 31.12.2023, ndërsa sipas Vendimit me numër protokoll 24 të datës 09.01.2023 të zv. Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës i është refuzuar kërkesa.

Ankuesi kundër këtij vendimi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës, më datë 03.04.2023 ka nxjerr Vendim A.nr.304/2023 me të cilin ka refuzuar ankesën e datës 02.02.2023 të ankuesit duke e lënë në fuqi Vendimit me numër protokolli 24 të datës 09.01.2023.

Më datë 11.05.2023 mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit ka paraqitur rastin e ankuesit në Komisionin Disiplinor me arsyetimin se ankuesi nuk është paraqitur në punë në afatin 5 ditor. Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës më datë 08.06.2023 ka nxjerr Vendimi me Nr. 7/2023 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"Largim nga shërbimi civil"*.

Ankuesi, kundër Vendimit me Nr.7/2023 të datës 08.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, më datë 07.07.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 21.09.2021 dhe është regjistruar më numër të ankesës A.nr.934/2023 dhe me numër protokolli 5094/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.07.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Administrata Tatimore e Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 13.07.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova:Ankesën me numër protokolli 5094/2023 e datës 07.07.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.7/2023 të datës 08.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës; Komunikimet me telefon; Raportet Mjekësore; Dokument identifikimi i ankuesit; Udhëzim për konsultime mjekësore; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 12.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 13.07.2023; Akt Emërimin AE.Nr.393/2022 të datës 31.12.2022; Vendimin me Nr. 2347 të datës 22.12.2022; Formularin për përshkrimin e detyrave të punës për inxhinier të Mesëm Tatimor; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 31.12.2018; Vendimin me numër protokolli 24 i datës 09.01.2023; Kërkesë e datës 20.12.2022 e ankuesit për pushim pa pagesë; Emailin e datës 05.12.2023 nga T.M për M.H; Emailin e datës 05.12.2022 nga ankuesi për T.M; Shkresë përcjellëse për Komisionin Disiplinor i datë 15.05.2023; Emailin e datës 12.05.2023 nga M.H për T.M; Emailin e datës 11.05.2023 nga T.M për M.H; Emailin e datës 11.05.2023 nga M.H për T.M; Emailin e datës 10.05.2023 nga B.H për M.H; Emailin e datës 08.05.2023 nga T.M për ankuesin; Emailin e datës 04.05.2023 nga ankuesi për T.M; Procesverbalin e datës 06.06.2023 të Komisionit Disiplinor; Raportin e vijueshmërisë në punë për ankuesin nga muaji janar-maj 2023; Emailin i datës 04.01.2023 për ankuesin nga T.M.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.7/2023 të datës 08.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës, pretendon se ky vendim është i kundërligjshëm për shkak që askush nuk më ka njoftuar se duhet të paraqitem në punë, sepse Menaxherja e Burimeve Njerëzore përmes emailit më ka thënë që meqë nuk je kthyer në vendin e punës pas vendimit për refuzim të kërkesës nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe refuzimit të ankesës nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës atëherë mundësia e fundit për të paraqitur në punë ka përfunduar pesë ditë pasi keni pranuar vendimin.

Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të lëndës, konstaton se inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është bërë për shkak se i njëjti nuk është paraqitur në vendin e tij të punës pas pranimit të Vendimit me numër protokolli 24 të datës 09.01.2023 të zv.Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës për refuzuar e kërkesës për pushim pa pagesë dhe pas Vendimit A.nr.304/2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është vendim përfundimtar dhe i zbatueshëm për palët në procedurë, dhe mbi këtë bazë çdo inicimin i konfliktit administrativ nuk e ndalon zbatimin e vendimit siç parashihet me nenin 22 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në provat e lëndës, ankuesi më datë 20.12.2022 ka paraqitur kërkesë për pushim pa pagesë prej 12 muaj apo një vit, ndërsa e njëjta kërkesë sipas provave të lëndës nuk është aprovuar, kështu që ankuesi edhe pse ka parashtruar kërkesë për pushim pa pagesë nuk është paraqitur në vendin e punës pavarësisht emailit të datës 04.01.2023 të dërguar nga Udhëheqësja e Njësisë së Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës e cila ka njoftuar ankuesin që edhe përkundër kërkesës është i obliguar që të paraqitet në vendin e punës brenda pesë (5) ditëve dhe nëse nuk paraqitet konsiderohet braktisje e vendit të punës, kështu që ankuesi edhe pas këtij paralajmërimi dhe vendimeve të lartcekura për refuzimin e kërkesës për pushim pa pagesë nuk është paraqitur në vendin e tij të punës nga data 01.01.2023 e deri në inicimin e procedurës disiplinore.

Sipas rregullativës ligjor në fuqi për zyrtarët publikë, zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës siç parashihet me nenin 25 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike"*, po ashtu zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit siç parashihet me nenin 26 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa sipas nenit 28 të këtij ligji parashihet: *'Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij'*, si rrjedhojë ankuesi me mos paraqitjen e tij në punë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: *"1. Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë prezent në vendin e punës. 2. Çdo zyrtar publik është i obliguar që*

të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, varësisht se cilën ka në përdorim institucioni. 3. Mosregjistrimi në librat e vijueshmërisë në punë apo në regjistrin elektronik, llogaritet si mosprezencë në punë. 4. Përgjegjës për vijueshmëri në punë të zyrtarëve publik, është mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 5. Mos respektimi i orarit të punës, sipas Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik paraqet shkelje disiplinore", meqenëse ankuesi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura, atëherë i njëjti ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuar me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht shkelje të rëndë disiplinore, braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë siç parashihet me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5 të këtij ligji.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, me rastin e parashtrimit të kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil", ndërsa Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës me rastin e nxjerrës së Vendimit me Nr. 7/2023 të datës 08.06.2023, në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen e bërë nga ankuesi, në këtë rast ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ka konstatuar saktë elementet e përgjegjësit disiplinore si: "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", po ashtu masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nenin 48 paragrafi 3, nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 11, nenin 12, nenin 13 paragrafi 3, paragrafi 4 nën paragrafët 4.1 dhe 4.2 dhe paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, në këtë rast Vendimi me Nr. 7/2023 i datës 08.06.2023 i Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës, është arsyetuar në përputhje të potë me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet e ankuesit se masa disiplinore e shqiptuar është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi janë të pabazuara.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.934/2023, datë 17/08/2023.

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit [REDACTED]
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.